



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4925 prot.

Himarë, më 02.07.2025

VENDIM

NR 29 DATE 27.06.2025

**MBI TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE HIMARË
SH.A INVESTIMIN ME OBJEKT UJËSJELLËS KANALIZIMEVE SH.A TË ASETEVE
UJËSJELLËSI BOLENË, UJËSJELLËSI KUÇ, UJËSJELLËS KALLARAT
QË DO TË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E DETYRAVE TË SAJ FUNKSIONALE NË
NJËSINË HORË-VRANISHT.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.2, shkronja "a", nenit 23, pikës 14, nenit 28, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, në ligjin nr 139/2015 "Për Vetëeverisjen Vendore", ligjit 9936 datë 26.08.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit Nr 68/2017 "Për Financat e Qeverisjes Vendore", ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 03.4.1993 "Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik" i ndryshuar, të Ministrisë së Financave, si dhe me propozim të derjtorisë së financës planifikimit të buxhetit dhe integritit evropian, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 27.06.2025 pasi miratoi me pesëmbëdhjetë (15) vota pro , katër (4) kundër , zero (0) abstenim si më poshtë ,

V E N D O S I

1. Të miratohet transferimi kapital pa pagesë të aseteve në pronësi të Ujësjellës Kanalizime Sh.A të aseteve Ujësjellësi Bolenë, ujësjellësi Kuc, ujësjellësi Kallarat
2. Ujësjellës SH.A, ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi.
3. Drejtoria e financës planifikimit të buxhetit dhe integritit evropian, ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas legjislacionit në fuqi.

KRYETARI
Dhimitër Kapaj

